

## THIRRJE PËR PROPOZIME PROJEKTESH

Ref. No: EA\_068/01-2026

### TITULLI I PROJEKTIT:

"PULSE - MBROJTJA E PEIZAZHEVE DHE SPECIEVE UNIKE NË SHQIPËRI DHE MAQEDONINË E VERIUT

Dorëzimi i propozim-projektit nga aplikantët e përfshirë në zonën e projektit që përfshin rajonin e Parkut Kombëtar "Mali Sharr", veçanërisht në komunat Tearcë, Jegunoc, Tetovë, Bogovinë dhe Vrapçisht, duke targetuar specifikisht fshatrat **Shipkovicë, Vejcë, Brodec, Veshallë dhe Bozofcë**. Skema e grantit mbështet përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për zhvillimin socio-ekonomik ndërkufitar të zonave të mbrojtura dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

### Njoftim me CNVP

CNVP është një organizatë me bazë në Holandë që vepron në Ballkan. Misioni i CNVP është të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të ofrojë mbështetje për komunitetet lokale dhe qeveritë në krijimin e një jeteje në harmoni me natyrën. Përmes projekteve të ndryshme, CNVP synon të kontribuojë për një Evropë Juglindore më të mirë, duke u fokusuar në gjashtë fusha kryesore:

1. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore
2. Ndryshimet klimatike
3. Zhvillimi rural
4. Energjia e ripërtëritshme
5. Mobilizimi i komunitetit
6. Integrimi evropian

CNVP, përmes zyrave të saj degë në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri, është duke zbatuar projektin tri-vjeçar "PULSE - **Mbrojtja e Peizazheve dhe Specieve Unike në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut**" në zonat e mbrojtura Korab-Koritnik, Mali Sharr dhe Alpet Shqiptare, i financuar nga Fondi i Natyrës Prespë-Ohrid (PONT).

Ky grant bazohet në arritjet dhe mësimet e nxjerra nga faza e parë e projektit (2022–2025). Gjithashtu, ai shfrytëzon përvojën e CNVP-së të mbështetur nga PONT në Prespë, së bashku me përvojën tonë të gjerë shumëvjeçare të punës me donatorë të ndryshëm në rajonin e Ballkanit.

Projekt synon të përmirësojë kushtet socio-ekonomike të komuniteteve lokale, duke kontribuar njëkohësisht në ruajtjen e natyrës. Ai fokusohet veçanërisht në përdorimin e qëndrueshëm të produkteve pyjore jomedicinale (NTFP) dhe turizmin e bazuar në natyrë, duke përdorur një qasje pjesëmarrëse, ndërkufitare dhe ndërsektoriale.

Projekti ka tre objektiva kryesore:

1. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për mbrojtjen e biodiversitetit, ruajtjen e mejsheve (habitateve), zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e njohurive teknike (know-how).
2. Diversifikimi i shërbimeve dhe produkteve të turizmit të bazuar në natyrë për të përmirësuar jetesën e komuniteteve lokale në zonat pilote.
3. Përmirësimi i qeverisjes me pjesëmarrje për një menaxhim më të mirë të Zonave të Mbrojtura.

Grantet u dedikohen kryesisht përfituesve të kualifikuar me prani lokale në zonat e mbrojtura dhe me një mision e strategji të fokusuar në ruajtjen e natyrës. Aktivitetet e pranueshme përfshijnë pjesëmarrjen e qytetarëve në përpjekjet për ruajtjen e natyrës, zhvillimin e shoqërive dhe komuniteteve lokale të qëndrueshme, si dhe nxitjen e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Thirrjet e Hapura për Propozim-Grante do të publikohen në faqen e internetit të CNVP-së dhe në kanalët e mediave sociale.

Aktivitetet e projektit duhet të zbatohen ekskluzivisht brenda mikro-rajonit të caktuar në Parkun Kombëtar "Mali Sharr", ose aktivitetet duhet të jenë të lidhura me kthimin e natyrës, kthimin shoqëror, inspirues dhe financiar, duke targetuar specifikisht fshatrat **Shipkovicë, Vejcë, Brodec, Veshallë dhe Bozofcë**.

## Informata të përgjithshme mbi grantin

### Vlera e granteve

Çdo grant i kërkuar sipas kësaj thirrjeje për propozime duhet të jetë brenda shumave minimale dhe maksimale të mëposhtme:

- Shuma minimale: EUR 5,000
- Shuma maksimale: EUR 10,000

Kohëzgjatja e zbatimit të grantit duhet të jetë në një periudhë prej 14 muajsh.

Materialet e aplikimit janë në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe, duke u mundësuar aplikantëve të zgjedhin gjuhën e preferuar në të cilën duah të aplikojnë.

Gjatë periudhës së thirrjes së hapur për aplikim, do të mbahen seanca informuese më 15 shtator 2026 **Europa House** Tetovë, ku aplikantët potencialë do të kenë mundësi të bëjnë pyetje lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzohet. Ju lutemi, pyetjet tuaja t'i dorëzoni deri më 21 shtator 2026, deri në orën 16:00. Të gjitha pyetjet nga aplikantët mund të dërgohen në adresën e postës elektronike: [questions@cnvp-eu.org](mailto:questions@cnvp-eu.org).

Propozim-projektet e plota duhet të pranohen vetëm në rrugë elektronike në adresën e mëposhtme të email-it: [cnvpmkd@cnvp-eu.org](mailto:cnvpmkd@cnvp-eu.org), ndërsa afati i fundit për dorëzim është jo më vonë se **05 tetor 2026**, deri në orën 16:00.

**Njoftim i rëndësishëm:** Informacione të detajuara mbi kriteret e pranueshmërisë dhe papranueshmërisë, aktivitetet e pranueshme dhe jo të pranueshme, kërkesat e bashkëfinancimit, kostot e pranueshme, procedurat dhe kriteret e vlerësimit, detyrimet kontraktuale, kërkesat e raportimit dhe monitorimit, procedurat e ankesave dhe të gjitha rregullat e tjera që zbatojnë skemën e granteve janë të dhëna në Manualin e Grantit.

## Aplikantët e pranueshëm për financim

Për të qenë i pranueshëm për grant, aplikanti duhet të jetë:

- **Organizata jofitimprurëse (OJF)** të regjistruara si organizata jofitimprurëse (jo zyra degë), sipas Ligjit për Shoqata dhe Fondacione të Republikës së Maqedonisë së Veriut, brenda territorit të komunave Tearcë, Jegunoc, Tetovë, Bogovinë dhe Vrapçisht, me fokus në fshatrat Shipkovicë, Veshallë, Brodec, Vejcë dhe Bozofcë, si dhe të jenë të regjistruara dhe aktive të paktën 12 muaj para datës së publikimit të thirrjes.
- **Biznese lokale** të regjistruara si persona juridikë (jo zyra degë) brenda territorit të komunave Tearcë, Jegunoc, Tetovë, Bogovinë dhe Vrapçisht, me aktivitete të fokusuara në fshatrat Shipkovicë, Veshallë, Brodec, Vejcë dhe Bozofcë, si dhe të jenë të regjistruara dhe aktive të paktën 12 muaj para datës së publikimit të thirrjes.
- **Fermë bujqësore** – të regjistruara si ekonomi bujqësore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, me aktivitete bujqësore në fshatrat Shipkovicë, Vejcë, Brodec, Veshallë dhe Bozofcë.

### E rëndësishme:

- Aplikantët në të cilët stafi i autoriteteve përkatëse të zonave të mbrojtura është i përfshirë si anëtar i organeve të qeverisjes dhe menaxhimit, apo vepron si staf/ekspert, **nuk kanë të drejtë aplikimi**.
- Aplikantët që aktualisht janë duke zbatuar projekte të financuara nga PONT **nuk kanë të drejtë të aplikojnë** në këtë thirrje.

- **Përfundim nga ky rregull:** Aplikantët, projektet e të cilëve të financuara nga PONT përfundojnë para skadimit të thirrjes aktuale për aplikim, kanë të drejtë të aplikojnë.

Schema e nën-granteve mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:

- Modernizimi, përshtatja dhe ngritja e kapaciteteve për përpunimin dhe ruajtjen e qumështit në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore dhe higjienës;
- Përmirësimi i mini-qumështoreve në komunitet përmes prokurimit dhe instalimit të pajisjeve eficiente të energjisë për grumbullimin, ftohjen, përpunimin, paketimin dhe kontrollin e cilësisë së qumështit, me synim minimizimin e mbetjeve të burimeve dhe reduktimin e gjurmës mjedisore.
- Furnizimi me pajisje të specializuara për të nxitur prodhimin e qëndrueshëm të mjaltit cilësor të malit dhe për të modernizuar praktikën e bletarisë;
- Blerja dhe instalimi i infrastrukturës mbrojtëse për aktivitetet e bletarisë, përfshirë rrethimet e sigurta ndaj kafshëve të egra dhe sistemet e monitorimit;
- Krijimi dhe ngritja nga pikëpamja mjedisore e qendrave të grumbullimit për produktet pyjore jo-drusore (NTFPs), bimët mjekësore dhe aromatike (MAPs), përfshirë pajisjet për renditje, tharje, paketim dhe ruajtje, si dhe trajnimet e komuniteteve lokale për grumbullimin e qëndrueshëm të NTFPs dhe MAPs në zonat e mbrojtura;
- Prokurimi i pajisjeve për përmirësimin e kapaciteteve për përpunimin dhe tharjen e produkteve pyjore jo-drusore dhe bimëve mjekësore e aromatike (Llojet e pajisjeve: pranim, grumbullim dhe ruajtje, përgatitje për renditje, pastrim, larje, tharje, dezinfektim, klasifikim, kalibrim, largim i frutave të dëmtuara, pajisje për prerje, bluarje dhe pajisje të tjera për përgatitje para përpunimit, pajisje për konservim, tharje, ngrirje, pajisje për mbushje, ambalazhim/shishe, paketim dhe etiketim/markim, pajisje për monitorimin e cilësisë, sisteme kontrolli me gjurmueshmëri të pranimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së produktit.)
- Përmirësimi i kapaciteteve për kultivimin organik të produkteve pyjore jo-drusore dhe bimëve mjekësore e aromatike, si dhe përfshirja e të rinjve dhe grave. (Ofrimi i trajnimeve, burimeve dhe mbështetjes për komunitetet lokale për t'i ndihmuar ato të zhvillojnë praktika kultivimi të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, të krijojnë lidhje me tregun dhe të promovojnë praktika të qëndrueshme).
- Prokurimi i pajisjeve për përpunimin dhe prodhimin e ushqimit me bazë tradicionale nga ofruesit e shërbimeve të turizmit të bazuar në natyrë (pajisje për përpunim: mullinj, bluarëse dhe dehidratues; pajisje për prodhim: furra, shporetë/sobë dhe pajisje kuzhine; pajisje për turizmin e bazuar në natyrë, si pajisje për ecje dhe kampim, pajisje për turizëm me avanturë, pajisje për me sporte ujore, vëzhgim të jetës së egër, etj.).
- Rehabilitimi, markimi, hartografimi digjital dhe promovimi i shtigjeve të ecjes, ciklizmit dhe eko-turizmit;
- Instalimi i infrastrukturës për vizitorët, përfshirë tabelat informuese, zonat e pushimit, pikat e vëzhgimit (pikëpamjet) dhe sinjalistikën e sigurisë përgjatë eko-shtigjeve;
- Masat për kontrollin e erozionit, stabilizimin e pjerrësive dhe me mbrojtjen/rikuperimin e ekosistemit në zonat e degraduara dhe mjedisisht të ndjeshme;
- Promovimi i turave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të mbështetur ekonominë lokale dhe për të ruajtur traditat kulturore. Mund të mbështeten gjithashtu edhe aktivitetet ndërkufitare për promovim.
- Rregullimi/përmirësimi i kapaciteteve private të akomodimit dhe objekteve pranë ofruesve të shërbimeve turistike/produkteve të bazuara në natyrë (për rregullimin, pajisjen ose rinovimin e objektit sipas traditës vendase).
- Konservimi dhe ruajtja e staneve tradicionale të barinjve dhe shndërrimi i tyre në objekte të eko-turizmit, qendra vizitorësh, njësi akomodimi për mysafirë dhe hapësira për demonstrime kulinare përmes masave të eficientës energjetike, praktikave të reduktimit të mbetjeve dhe teknologjive për kursimin e ujit.

**E rëndësishme:** Kjo është një listë jo-shteruese (jo-ekskluzive).

## Procesi i vlerësimit

Procedura për vlerësimin e aplikimit përbëhet nga dy faza: kontrolli administrativ dhe vlerësimi i aplikimeve. Vetëm aplikimet që kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen nga komisioni i vlerësimit. Gjatë kontrollit administrativ verifikohet përmbushja e kushteve të mëposhtme:

- Afati i dorëzimit të aplikimit të pranuar.
- Plotësia e aplikimit.
- Plotësimi i saktë i aplikimit.
- Nëse janë përmbushur kushtet e pranueshmërisë.

Nëse aplikimi nuk i plotëson këto kushte, ai do të refuzohet dhe aplikanti do të njoftohet.

Një komision i pavarur vlerësimi do të përzgjedhë propozim-projektin më të mirë që plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara më sipër. Komisioni i vlerësimit do të përbëhet nga një numër tek anëtarësh dhe do të vlerësojë aplikimet e pranura sipas kësaj thirrjeje. Kriteret e vlerësimit dhe pesha e tyre për përfituesit e mundshëm janë transparente dhe të hapura për publikun. Lista e fituesve të përzgjedhur për financim do të shpallet publikisht.

## Dokumentet e mëposhtme duhet të dorëzohen për:

- **Organizatë jofitimprurëse (OJF) dhe biznes lokal (person juridik):**
  - Formulari i aplikimit Shtojca 1, i plotësuar sipas modelit të ofruar;
  - Formati i buxhetit Shtojca 2, i plotësuar sipas modelit Excel të ofruar;
  - CV-të e stafit të projektit të përfshirë në propozim-projekt;
  - Dokumenti zyrtar i regjistrimit (forma juridike) nga Regjistri Qendror i RVM-së (jo më i vjetër se 3 muaj);
  - Pasqyrat Financiare për vitin 2025 – të dorëzuara zyrtarisht në Regjistrin Qendror të RVM-së.
    - OJF-të, të cilat kanë një të ardhur totale nën 2,500 Euro, duhet të dorëzojnë një deklaratë se nuk kanë dorëzuar Pasqyrë Financiare vjetore për vitin 2025.
  - Deklarata e aplikantit, e dorëzuar me nënshkrim dhe vulë.
- **Fermë bujqësore (Ekonomi bujqësore)**
  - Formulari i aplikimit Shtojca 1, i plotësuar sipas modelit të ofruar;
  - Formati i buxhetit Shtojca 2, i plotësuar sipas modelit Excel të ofruar;
  - CV-të e stafit të projektit të përfshirë në propozim-projekt;
  - Deklarata e aplikantit, e dorëzuar me nënshkrim dhe vulë;
  - Kopje e dokumentit të vlefshëm të identifikimit (letërnjoftimit);
  - Dëshmi e regjistrimit si fermer individual e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (Vendimi për regjistrim në ERBU);

## Korniza kohore indikative

| Korniza Kohore Indikative                         | Data                 |
|---------------------------------------------------|----------------------|
| Shpallja e thirrjes                               | 04 Shtator 2026      |
| Sesionet informuese                               | 15 Shtator 2026      |
| Afati i fundit për pyetje dhe kërkesa për sqarime | 21 Shtator 2026      |
| <b>Afati i fundit për aplikim</b>                 | <b>05 Tetor 2026</b> |